



Pavarësi për institucionet botërore të auditimit: Një hap më afër

INTOSAI mirëpret deklaratën e takimit të nivelit të lartë mbajtur në Londër në datën 12 Maj 2016 “*Mbi antikorrupsionin*” për njohjen e rolit të rëndësishëm të Institucioneve të larta të auditimit(SAIs) në luftën kundër korrupsionit.

Liderët e nivelit të lartë në këtë takim, bëjnë thirrje qeverive në mbarë botën të forcojnë:

"..kapacitetet e institucioneve të larta të auditimit.."

Vendet pjesmarrëse në Takim bien dakord që:

"Të punojnë së bashku të forcojmë transparencën e shpenzimeve buxhetore, duke përfshirë dhe mbikqyrjen nga ligjvënësit të procedurave buxhetore dhe forcimin e kapaciteteve të institucioneve të larta të auditimit. Konferenca përkrah pavarësinë e institucioneve të larta të auditimit si dhe publikimin e raporteve të auditimit".

INTOSAI për një kohë të gjatë ka bërë fushatë pranë ligjvënësve, për pavarësi të SAI, me qëllim që të mund të detyrojë qeveritë të japin llogari për shpenzimin e fondeve publike dhe të forcojnë menaxhimin e përdorimit të tyre.

Në vijim të deklaratës së Meksikos, përkrahur me rezolutë të veçantë nga Asambleja e Kombeve të Bashkuara si dhe nga lëvizja botërore për transparencë të shpenzimeve qeveritare, institucionet e larta të kontrollit duhet të kenë të garantuar pavarësinë nga qeveria, mandat të garantuar, jo kufizim në informacionin që i duhet si dhe burime njerëzore të mjaftueshme për auditim dhe raportim tek publiku të mbledhjes dhe përdorimit të fondeve publike. SAI-t duhet të jenë të aftë të punojnë në kushtet e një pavarësie, llogaridhënieje dhe transparence të punës së tyre.

Gjatë këtyre viteve, INTOSAI ka punuar shumë për përshtatjen e standarteve ndërkombëtare të auditimit dhe ndihmojë në përmirësimin e cilësisë së auditimit publik, të vlefshme për parlamentet dhe qytetarët.

Por përmirësimet duan kohë. Shumë vendeve u mungojnë personeli i kualifikuar për aplikimin e standarteve të reja të auditimit, ju mungon pavarësia dhe fuqia për të prodhuar në kohë raportet e auditimit të cilët të behen të vlefshëm për parlamentin dhe qytetarët, brenda një afati kohor të arsyeshëm.

Brenda familjes së madhe të INTOSAI, ka shumë zhvillime positive të cilat mund të lozin një rol më efektiv në përkrahjen e zhvillimit kombëtar. Vitin e kaluar, për shembull, parlamenti i Ukrainës aprovoi një ligj i cili i garanton zyrës së Lartë të Llogarive të Ukrainës më shumë fuqi, në një linjë me standartet ndërkombëtare të auditimit.

Tjetër shembull pozitiv, midis shumë të tjerëve është dhe vendosja në Kushtetutën e Vietnamit të pavarësisë së SAI-t.

INTOSAI është i shqetësuar se zbulime me vlerë në lidhje me përdorimin e fondeve publike, si korrupsioni dhe keqmanaxhimi i fondeve publike, të zbërthyer në raportet e nxjerra nga institucionet e larta të auditimit, nuk janë ndjekur dhe vënë në vëmendje të qeverive.

INTOSAI e përcjell këtë shqetësim tek ky takim dhe fuqimisht kërkon që:

“Të gjithë vendet dhe anëtarët e INTOSAI duhet të publikojnë raportet e auditimit dhe zbatimin e rekomandimeve brenda një kohe të pranueshme. Aty ku raportet e auditimit kanë evidentuar raste të korrupsionit dhe mashtrimit ndjekja e këtyre gjetjeve duhet të bëhet me përparësi”

INTOSAI qëndron fuqishëm në krah të përpjekjeve globale për luftën kundër korrupsionit, mungesës së menaxhimit dhe mashtrimit me fondet publike.